



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS  
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA  
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

**Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës**, bazuar në nenin 29 paragrafi 2 nënparagrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës , nenin 17 paragrafi 2 nënparagrafi 6 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe bazuar në nenin 7 paragrafi 2 pika f) të Rregullores për Punën e Bordit të RTK-së, në mbledhjen e datës 19.01.2022, me 9 (nëntë) vota PËR dhe asnjë votë KUNDËR, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. Shkarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës, z. Ngadhnjim Kastrati.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### ARSYETIM

Sipas Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, respektivisht nenit 31 paragrafi 2 nënparagrafi 2 dhe 3, anëtari i menaxhmentit të lartë të RTK-së mund të shkarkohet, ndër të tjerash, në rast se dështon në kryerjen e punëve të tij në mënyrë efektive dhe në rast se vepron në kundërshtim me këtë ligj.

Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës z. Ngadhnjim Kastrati ka dështuar në kryerjen e punëve të tij në mënyrë efektive dhe ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për RTK-në, si në vijim:

- **Ka dështuar të sigurojë respektimin e kërkesave që dalin nga Ligji për RTK-në Nr. 04/L-046** - Kësisoj, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, ka dështuar të sigurojë që të respektohen kërkesat që dalin nga Ligji për RTK-në, konkretisht:

**Shkelja e nenit 33 paragrafi 1 nënparagrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për RTK-në Nr. 04/L-046** – Këto shkelje evidentohen me faktin se Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, funksionimin e njësive kryesore të RTK-së e ka bazuar në punonjësit me kontrata për shërbime. Deri me datën 31 dhjetor të vitit 2021, RTK ka pasur 239 persona të angazhuar me kontrata për shërbime. Shumica nga ta janë angazhuar për punët më esenciale të funksionimit të RTK-së, si: gazetarë, kameramanë, montazhierë, punëtorë të sigurimit, etj. Këtë e ka konfirmuar edhe vet Drejtori i

Përgjithshëm përmes emailit të datës 31.12.2021 dhe 12.01.2022, se funksionimi i shumë njërive të RTK-së varet nga personat e angazhuar me këto kontrata. **Drejtori i Përgjithshëm, për gati tri vite të mandatit të tij, ka dështuar të hapë konkurse për të rekrutuar punëtorët e nevojshëm për funksionimin siç duhet të RTK-së.** Në mungesë të konkurseve, janë angazhuar persona pa iu nënshtruar vlerësimeve rekrutuese, ndërsa kontratat e tyre janë vazhduar në mënyrë periodike për vite të tëra. Në anën tjetër, kjo formë e angazhimit me kontrata për shërbime, nuk parasheh asnjë lloj të pushimit dhe benefiteve të tjera që i garanton Ligji i Punës për punëtorët e rregullt. Ka punëtorë të angazhuar me kontrata për shërbime, që përmes emailit i kanë shkruar Bordit aktual të RTK-së, se për shumë vite (përfshirë edhe tri vitet e fundit) nuk kanë marrë asnjëherë pushim javor, mujor apo vjetor.

**Shkelja e nenit 35 paragrafi 5 të Ligjit për RTK-në** – Kjo shkelje evidentohet me avancimin dhe emërimin e stafit të RTK-së; me konkretisht emërimi i u.d. Kryeredaktorit të RTK1, i cili është emëruar me vendim të menaxhmentit duke mos respektuar Ligjin e Radiotelevizionit të Kosovës, përkatësisht nenin 35 paragrafi 5, ku thuhet se “Secili Kryeredaktor i RTK-së zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në bazë të konkursit publik dhe sipas rekomandimit të drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtorit të radios”. Kjo po ashtu precizohet edhe në nenin 24 të Statutit të RTK-së, ku po ashtu thuhet se “Secili Kryeredaktor i RTK-së zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në bazë të konkursit publik”.

Në vendimin e kontratës së u.d. Kryeredaktorit të nënshkruar nga U.D. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së thuhet se “caktohet u.d. Kryeredaktori duke filluar nga data 01.05.2019 deri në përzgjedhjen e Kryeredaktorit të RTK 1- TV”. Ndërsa, në vendimin e aneks kontratës të u.d. Kryeredaktorit të nënshkruar nga U.D. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, z. Mufail Limani, në nenin 3 tek kohëzgjatja e aneks kontratës thuhet se “Ky aneks i kontratës lidhet për një periudhë të caktuar kohore duke filluar 01.05.2019 deri në përzgjedhjen e Kryeredaktorit të RTK 1 - TV, por jo më shumë se 6 muaj nga vendimi i emërimit”. Në takimin e Bordit me Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së të datës 23.12.2021, Drejtori z. Ngadhnjim Kastrati i ka konfirmuar Bordit se u.d. Kryeredaktori vazhdon të jetë po i njëjti person edhe tani që nga viti 2019, kështu që rezulton se Menaxhmenti i tanishëm ka lejuar shkeljen e Ligjit për RTK-në për përzgjedhjen e kryeredaktorit të RTK 1 TV.

**Shkelja e nenit 33 paragrafi 1 nënparagrafi 7 të Ligjit për RTK-në** - Ka dështuar të sigurojë respektimin e Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore me numër 0736/18 e datës 05.06.2018. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së nuk ka ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit të këtyre shkeljeve të punëtorëve të paraqitura në vijim:

Shkelja e nenit 6 pika 1.1 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore – Kjo shkelje dëshkohet me shkresat e shpeshta, të cilat janë dërguar tek punonjësit e institucionit për respektim të orarit të punës, ndonëse nuk është paraqitur ndonjë evidencë e detajuar lidhur me masat e ndërmarra për shkelësit të cilëve u adresohet kërkesa konkrete për mungesat në punë.

Rast konkret është emaili i dërguar nga Administrata me datë 10 janar 2022, në ora 12:51, ose emaili i dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm me datë 12 janar 2022, në ora 16:14, përderisa as mes këtyre dy kërkesave e as pas tyre, nuk është raportuar për marrje të masave ndaj atyre që nuk respektojnë kontratat e punës me RTK-në.

Shkelja e nenit 6 pika 1.3 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore – Kjo shkelje dëshmohet nga deklaratimet publike, qoftë përmes shkrimeve në rrjetet sociale, qoftë nga pjesëmarrja në debate publike në mediumet e tjera, apo edhe promovimi i mediave tjera nga punonjësit e rregullt të RTK-së, aktivitete këto që cenojnë besueshmërinë e RTK-së, siç janë rastet e producentëve ekzekutivë, redaktorëve apo gazetarëve të punësuar në RTK, për të cilët Drejtori i RTK-së nuk është siguruar që janë marrë masat sipas rregullativës së RTK-së. Raste të tilla ka shumë, por më poshtë janë të listuara disa prej tyre:

- <https://fb.watch/aCTP2lbnGd/>
- <https://www.facebook.com/100010561562194/posts/1601041966924507/?d=n>
- <https://www.facebook.com/100010561562194/posts/1600445133650857/?d=n>
- <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=10165931053880383&set=a.10152208415475383&type=3>
- <https://www.facebook.com/100010561562194/posts/1566549597040411/?d=n>
- <https://www.periskopi.com/bukuroshja-mentor-shala-i-rtk-se-me-gjuhe-te-papranueshme-ndaj-deputetes-kica-xhelili/>
- <https://youtu.be/S760h6abq5I>
- <https://indeksonline.net/reagon-gazetari-i-rtk-se-marre-u-beme-si-tv-i-korese-se-kim-jong-un/>
- <https://gazetainfokus.com/tpshu-ne-presidenten-qe-e-kemi-q-bre-nanen-eskalon-ridvan-berisha/>
- <https://kallxo.com/lajm/ridvan-berisha-deklarohet-se-nuk-do-ta-ftoj-ne-debat-albin-kurtin/>
- <https://m.youtube.com/watch?t=6199&v=FTbTYUOeyRo&feature=youtu.be/>, etj.

Shkelja e nenit 7 pika 1.1, 1.2, 1.4, 1.7, 1.24 dhe 1.42 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore – Këto shkelje dëshmohen me praninë e të punësuarve të RTK-së në media tjera konkurrencte, në programe me karakter kryesisht politik, si dhe me mungesën e evidencave të marrjes së masave për pjesëmarrje në aktivitete të tilla të organizuara nga mediat tjera konkurrencte vendore. Pjesëmarrja e të punësuarve në aktivitete të tilla me karakter debatues politik, publikimi i deklaratave të njëanshme politike në rrjetet sociale si dhe shpërndarja e përmbajtjes së mediave konkurrencte nga personat e punësuar në RTK, dëmtojnë imazhin dhe pavarësinë editoriale të transmetuesit publik, për çfarë Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në vazhdimësi ka dështuar të sigurojë se janë marrë masat e duhura sipas rregullativës në fuqi. Raste të tilla ka shumë, disa nga listimet në pikën paraprake vlejnë edhe këtu, përveç nga rastet e mëposhtme që listohen sa për ilustrim:

- <https://www.facebook.com/1003317519/posts/10224922719867590/?d=n>
- <https://www.facebook.com/1003317519/posts/10224910481721644/?d=n>
- <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=10165690525530383&set=a.10152208415475383&type=3>
- <https://klankosova.tv/luma-lista-vjosa-do-te-ishte-nje-ldd-e-diteve-te-sotme-po-te-mos-bashkohej-me-vv-ne-video/>
- <https://www.gazetaexpress.com/dy-tri-fjale-per-zgjedhjet-nga-mufail-limani/amp/>

Shkelja e nenit 7, pika 1.5, 1.8, 1.10 dhe 1.16 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore –

Raste ilustruese për këto shkelje konsiderohen rasti i Producentit Ekzekutiv z. Milaim Zeka, i cili ka deklaruar publikisht (<https://www.facebook.com/Kanal10.live/posts/481428100302618>) se nuk kryen detyra të punës në RTK, ndonëse paguhet për t'i bërë ato, ose rasti i Redaktorit Përgjegjës i Informacionit z. Ridvan Berisha, i cili vazhdon të mbetet i mos-angazhuar në punë që nga masat e marra ndaj tij në Prill të vitit 2021. Sipas një e-maili të dërguar nga z. Berisha tek menaxhmenti i RTK-së dhe te Bordi i RTK-së, me datë 10.01.2022, i njëjti deklarohet se vazhdon të paguhet, ndonëse ka afërisht një (1) vit që nuk paraqitet në punë. Shkeljet e tilla nga menaxhmenti i RTK-së përbëjnë keqpërdorim të parasë publike, meqë persona me koeficiente të larta pagash, paguhen dhe nuk prodhojnë punë për RTK-në.

Nga ana tjetër, menaxhmenti i RTK-së, përkatësisht drejtori i përgjithshëm i RTK-se kërkon në vazhdimësi angazhimin e personave shtesë me kontratë për shërbime, duke aluduar në atë se RTK nuk funksionon pa këta të angazhuar, përderisa në anën tjetër ka punonjës të rregullt të RTK-së, të cilët nuk paraqiten në punë, mirëpo të njëjtit vazhdojnë të paguhen dhe ndaj të cilëve nuk merren masa sipas Ligjit të Punës dhe rregulloreve të brendshme të RTK-së.

Shkelja e Standardeve Profesionale dhe Parimeve Etike të Gazetarisë të RTK-së, konkretisht pikat: 1.2, 1.4, 1.5, 1.7, 1.8, 2.2, 2.3.3, 5.4, 5.7, 22, 23.5 dhe 23.7 – Këto shkelje dëshmojnë me faktin që personat e punësuar në RTK, përfshirë persona në pozita menaxheriale, vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetet e njëjta (deklarime të anuara politikisht, debate politike dhe shpërndarje të programit të mediave tjera), ndonëse këto aktivitete janë të sanksionuara nga rregulloret e brendshme të RTK-së, që nënkupton që për shkeljen e të njëjtave, vazhdohet të mos merren masa korrigjuese dhe për të njëjtat nuk janë marrë masa disiplinore sipas listës që e ka dërguar menaxhmenti në Bordin aktual për masat disiplinore të marra gjatë periudhës 2019-2021. Kjo shkelje vazhdon të bëhet në raste të shumta, sidoqoftë dy janë rastet që ilustronjë këtë shkelje: (1) Rasti i angazhimeve të punonjësve të RTK-së në mediat e tjera dhe publikimi i materialeve në kundërshtim me rregulloret e brendshme nga RTK nga Producenti Ekzekutiv z. Milaim Zeka, Producenti Ekzekutiv z. Blerim Haxhiaj, Redaktori Përgjegjës i Programit Informativ z. Ridvan Berisha, Drejtori i Radios, z. Ernest Luma si dhe menaxheri për strategji, z. Mufalil Limani, të cilët angazhohen në mediat e tjera konkurrencte dhe/ose shpërndajnë materiale të atyre mediave

në rrjetet e tyre sociale, si dhe (2) Rasti i angazhimit në mediat e tjera, duke mbajtur aksionet e tyre, siç është rasti me Redaktorin e Programit z. Fazli Veliu, i cili figuron si pronar në “Radio Vizioni” sipas informatave zyrtare të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (<https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,47121>).

- **Ka dështuar të sigurojë në ofrimin e informimit publik dhe shpërndarjes së përmbytjes së ofruar nga RTK për komunitetet e tjera, siç kërkohet me nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafi 8 të Ligjit për RTK-në**

Kjo shkelje evidentohet me faktin se në faqen zyrtare të RTK-së në internet, cenohet e drejta e informimit të komuniteteve të tjera. Kjo për faktin se në faqen [www.rtklive.com](http://www.rtklive.com), lajmi i fundit i publikuar në gjuhën turke është më 02.08.2013, në gjuhën boshnjake më 05.12.2016, si dhe në gjuhën rome, është më 11.12.2016, edhe pse në Departamentin e Mediave Online të RTK-së figurojnë 24 punëtorë me kontrata të papërcaktuara, si dhe 11 të angazhuar me kontrata për shërbime. Pra, me një staf prej gjithsej 35 punëtorësh, përkatësisht të angazhuarve, sa ka pasur Departamenti i Mediave Online gjatë vitit 2021, informimi për komunitetet e tjera si komuniteti boshnjak, turk, rom, ashkali dhe egjiptian, ka munguar.

Përkundër faktit që në bazë të Rregullores për Kompetencat dhe Përgjegjësitë Nr. 1355/17, neni 34 për Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Udhëheqësit të Mediave Online, pika 2, bartë përgjegjësi editoriale për të gjitha publikimet, si tekstuale ashtu edhe vizuale në mediat online, si dhe në bazë të pikës 4 të po këtij neni, koordinon përzgjedhjen e materialeve për publik në mediat online të RTK-së. Ky mos-informim i komuniteteve të tjera përben shkelje ligjore, respektivisht shkelje e Ligjit për RTK-në neni 7, pika 1.8, ku RTK obligohet në realizimin e të drejtave kushtetuese të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera kombëtare në lidhje me ofrimin e informimit publik dhe shpërndarjen e përmbytjes së ofruar nga RTK. Ky problem identifikohet edhe në Raportin e Progresit për vitin 2021 të Komisionit Evropian për Kosovën, ku theksohet se qëndrueshmëria e pamjaftueshme e programeve në gjuhët jo-shumicë dhe prania e dobët të RTK-së në internet. Në këtë rast gjithashtu është shkelur edhe pika 11, 18, si dhe pika 23 e Standardeve Profesionale dhe Parimeve Etike të Gazetarisë të RTK-së.

Në mbledhjen e Bordit me Drejtorin e Përgjithshëm të datës 23.12.2021, është identifikuar kjo shkelje nga ana e mediave online në RTK, edhe pse sipas Drejtorit nuk kishte njohuri për një shkelje të tillë. Përkundër vërejtjeve të Bordit, Menaxhmenti ende nuk ka ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme.

- **Ka dështuar të sigurojë respektimin e kërkesave për raportim dhe dokumentim që dalin nga neni 20 i Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës - Kësisoj, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së ka dështuar të sigurojë respektimin e kërkesave që dalin nga Statuti në fjalë, konkretisht:**

**Shkelja e nenit 20 pika 1 të Statutit të RTK-së** – Kjo shkelje evidentohet në Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23 dhjetor 2021, ku Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së nuk ka shpalosur informacione të sakta në pyetjen nëse në RTK ka punonjës që paguhen dhe nuk vijnë në punë ose nuk prodhojnë material për transmetim. Në këtë pyetje, Drejtori është përgjigjur që nuk ka asnjë punëtor që paguhet pa punuar, përderisa evidentohet që ka raste të tilla sipas pikave tjera të sqaruara në këtë vendim. Për më tepër, Drejtori i Përgjithshëm, sipas Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 23 dhjetor 2021, deklaroi që nëse një punonjës nuk paraqitet në punë për më shumë se 3 ditë, komisioni disiplinor merr masa adekuate, gjë që nuk ka ndodhur për disa raste të evidentuara në këtë vendim dhe për të cilat deklarohen vet punonjësit e RTK-së që paguhen, por nuk punojnë.

Si pikë shtesë e kësaj, konsiderohet fakti se deri me datë 23 dhjetor 2021 (sipas deklaratave të Drejtorit të Përgjithshëm, të evidentuara në Procesverbal), nuk ka pasur vlerësim të saktë për nevojat e punonjësve me kontratë për shërbime. Fillimi për diskutimin e kësaj nevoje nisë vetëm pas kërkesës së Bordit aktual të RTK-së, që buxheti i parashikuar i RTK-së të jetë në harmoni me fondet në dispozicion, meqë nuk mund të aprovohet një projektbuxhet financiar, i cili tejkalon të ardhurat e RTK-së për të paktën 2.2 milionë euro. Kësisoj, projektbuxheti i parë i propozuar ndaj Bordit të RTK-së, nuk ka qenë në harmoni me gjendjen faktike të RTK-së dhe i njëjti është hartuar duke marrë për bazë buxhetin e disponueshëm të viteve paraprake, mirëpo nuk është analizuar në tërësi nevoja faktike e institucionit për ato mjete. Rrjedhimisht, planifikimi joadekuat i projektbuxhetit, për shkak të mosplanifikimit në kohë, mos planifikimit të detajuar rreth të hyrave dhe shpenzimeve dhe në harmoni jo të plotë me nevojat e RTK-së dhe fondet e disponueshme, ka bërë që Bordi aktual i RTK-së ta refuzojë projektbuxhetin dy (2) herë, me datë 23 dhjetor 2021 dhe 16 janar 2022. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me skemën programore të planifikuar për vitin 2022, e cila nuk është në linjë me buxhetin në dispozicion, nuk paraqet strategji konkrete për produksionet e brendshme dhe të jashtme si dhe bazohet në masë të madhe në punonjësit e angazhuar me kontrata për shërbime, ndonëse kjo çështje është aktivitet esencial i transmetuesit publik.

**Shkelja e nenit 20 pika 3 të Statutit të RTK-së** – Kjo shkelje evidentohet me faktin se Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së nuk ka arritur që në mënyrë të saktë dhe transparente ta informojë Bordin rreth afarizmit të RTK-së, konkretisht duke mos pasur njohuri ose duke mos i shpalosur ato para bordit, kryesisht rreth çmimit mesatar për sekondë në marketing, kur dihet se të ardhurat nga marketingu përbëjnë shtyllën kryesore për financim, pas fondeve të ndara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm nuk ka ofruar të dhëna para Bordit të RTK-së për përqindjen e marketingut që RTK e ka pasur në vitin paraprak në kuadër të tërësisë programore prej 10 përqind. Ashtu sikurse evidentohet në procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me datë 23.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm nuk ka shpalosur informacione të sakta lidhur me mënyrën e kontraktimit të reklamave, të ardhurat që gjenerohen nga ky aktivitet, si dhe nuk ka prezantuar ndonjë strategji rreth rritjes së këtyre të ardhurave.

**Shkelja e nenit 20 pika 4 të Statutit të RTK-së** – Kjo shkelje evidentohet me faktin që Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së nuk ka prezantuar Strategjinë Zhvillimore të RTK-së, ndonëse kjo çështje kërkohet nga Ligji për RTK-në dhe nga Statuti i RTK-së. Mungesa e strategjisë për zhvillimin e RTK-së, paraqet problematikë të theksuar, përtej faktit që nuk respektohet Statuti dhe Ligji për RTK-në, për arsye se në mungesë të strategjisë zhvillimore, bëhet projeksion joefektiv dhe joefikas i skemës programore dhe buxhetit për vitin pasues. Në anën tjetër, mungesa e kësaj strategjie krijon situatën kur menaxhmenti i RTK-së nuk ka plan ose strategji specifike rreth zhvillimit të marketingut për të rritur të ardhurat e RTK-së nga ai aktivitet, nuk ka strategji specifike të zhvillimit dhe produktivitetit të burimeve njerëzore, gjë që çon në keqmenaxhimin e buxhetit përmes kontratave për shërbime për pozicionet esenciale të RTK-së, si dhe nuk ka strategji afatgjate rreth rregullimit të menaxhimit të financave të institucionit.

Për më tepër, në lidhje me të njëjtën pikë, në Rregulloren 1355/17 për Kompetencat dhe Përgjegjësitë, tek neni 26 Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, pika 6 , kërkohet që Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së ta përgatitë strategjinë e zhvillimit të RTK-së, e cila strategji nuk i është prezantuar Bordit të RTK-së. Në komunikimet zyrtare të Bordit aktual me Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së, ai nuk ka ofruar dëshmi se ka hartuar një Strategji Zhvillimore të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe gjithashtu në mbledhjen e tij me Bordin më datë 16.01.2022, ka konfirmuar se është e vërtetë se Radiotelevizioni i Kosovës nuk posedon një Strategji Zhvillimore të RTK-së, e kjo ka ndodhur, sipas tij, për shkak të financimit jo të qëndrueshëm të RTK-së.

- **Ka dështuar të sigurojë respektimin e kërkesave dhe detyrave që dalin nga rregulloret, ligjet dhe statuti me të cilat operon RTK, ku për pasojë Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka evidentuar shkelje të ndryshme dhe mos-sanim të situatës, përkatësisht shkeljeve pas dhënies së rekomandimeve - Kësisoj, Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së ka lejuar aktivitete jo të rregullta, të cilat evidentohen nga NjAB, si në vijim:**

**Evidentohet avancimi jo-ligjor i stafit të RTK-së, ku konstatohet edhe nga Auditori i brendshëm në raportin e Auditimit të vitit 2020 “Pajtueshmëria e vendeve të punës”, se avancimet kanë ndodhur përmes vendimit për ri-sistemim.** Nga rishikimi i dokumentacionit në dispozicion, NjAB ka konfirmuar se pozitat e identifikuara nga Auditori nuk janë pjesë e Metodologjisë së Përcaktimit të Ndërlikueshmërisë së vendeve të punës, sipas Rregulloreve të Metodologjisë së Përcaktimit të Ndërlikueshmërisë së Vendeve të Punës.

**Evidentohet keqmenaxhimi dhe mungesa e vullnetit për të përmirësuar dhe zgjidhur problemet në RTK.** Kjo nënkupton mosgatishmërinë e Drejtorit të Përgjithshëm, për të zgjidhur problemet e identifikuara ndër vite, të cilat probleme janë të identifikuara edhe në raportet e Auditimit, duke shkaktuar kështu një keqmenaxhim të RTK-së dhe shkelje të rregullativës

ligjore. Një ndër problemet më të dukshme është numri i madh i kontratave për shërbime që janë lidhur për vite të tëra me persona të njëjtë, duke përjashtuar nevojën dhe mundësinë për konkurs publik, si dhe duke rrezikuar funksionimin e RTK-së. Në qoftë se analizohen listat e këtyre kontratave, vërehet se RTK ka pasur deri në 6 vite e më shumë, kontrata të njëjta me të njëjtit persona për shërbime të njëjta, duke krijuar kështu rrezikun që çdo vit të përsëritet gjendja e njëjtë e vazhdimit të kontratave me shërbime, e të mos mundësojë rekrutim të rregullt të stafit të domosdoshëm të RTK-së përmes Konkursit Publik.

Problemet në vazhdimësi me shtimin e kontratave për shërbime gjatë mandatit të tij tre (3) vjeçar, si Drejtor i Përgjithshëm mos-zgjedhja e kryeredaktorit përmes konkursit publik ashtu siç e parashih Ligji për RTK-në, si dhe mosbashkëpunimi me Auditorin e Brendshëm, apo refuzimi për të zbatuar rekomandimet e Auditorit të përgjithshëm, si dhe qasja penguese ndaj punës së NjAB-it lidhur me mos ofrimin e dokumentacionit të kërkuar me kohë kanë shkaktuar probleme të vazhdueshme në funksionimin e RTK-së. Refuzimi dhe qasja penguese ndaj NjAB konstatohet edhe tek Raporti i përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2019, ku në mes tjerash thuhet se “Gjatë aktivitetit njëvjeçar sfidues, NjAB, fatkeqësisht, ka qenë dëshmitare e një angazhimi dhe përkushtimi në rënie për bashkëpunim dhe zbatim të rekomandimeve”.

**Evidentohet keqmenaxhimi i aktiviteteve të prokurimit 2021, ku konstatohet se Menaxhmenti në vazhdimësi ka lejuar që të bëhet planifikim shabllon dhe jo një planifikim i mirëfilltë dhe i duhur i nevojave të RTK-së.** Dështimi i Drejtorit të Përgjithshëm të RTK në kryerjen e punëve të tij në mënyrë efektive si dhe veprimi në kundërshtim me ligjet e marrëdhënies së punës dhe ligjet tjera përkatëse, mund të konstatohet edhe në mos menaxhimin e problemeve dhe keqpërdorimeve të identifikuara brenda RTK-së të cilat mund të cenojnë funksionimin e saj, siç është rasti i identifikimit nga NjAB në Raportin e Auditimit “Menaxhimi i Aktiviteteve të Prokurimit 2021”, ku konstatohet se ka mungesë të raporteve nga ana e menaxherëve të kontratave në RTK. Kjo nënkupton se në RTK mungojnë raportet për evidentimin e zbatimit të kontratave të RTK-së që i ka me operatorët e ndryshëm, e që kjo ka rritur rrezikun që RTK të mos marrë cilësinë/sasinë e mallit, shërbimit apo punës së kontraktuar.

**Evidentohet keqmenaxhim nga ana e menaxhmentit të RTK-së në menaxhimin e kontratave të Marketingut në RTK.** Siç është rasti i konstatuar në Raportin e Auditimit “Aktivitetet e Marketingut për Kontratat me Kompensim 2021”, për keqpërdorimet me telefonat mobil të RTK-së të cilët kanë qenë të dedikuar të shpërndahen në bazë të nevojave të udhëheqësve të sektorëve dhe nevojave programore për xhirime përmes sistemit MoJo (Mobile Journalism). Mirëpo, këta telefona mobil janë dhuruar (shpërndarë) kryesisht për ish-anëtarët e Bordit, anëtarët e Menaxhmentit të lartë të RTK-së, si dhe për disa nga menaxherët e njësisive, ndërsa vetëm dy (2) sosh janë ndarë për gazetarët, përkundër faktit që këta telefona kanë qenë të dedikuar të shpërndahen në bazë të nevojave programore për xhirime përmes sistemit MoJo (Mobile Journalism). Kjo nënkupton se vetëm 10.5% kanë shkuar sipas destinimit real. Pika 2 e Vendimit të Menaxhmentit nr. 0273/21, të datës 09.02.2021, thotë se: “Të përpilohet lista e



shpërndarjes së tyre (telefonave v.j.) në bazë të nevojave të udhëheqësve të sektorëve dhe nevojave programore për xhirime përmes sistemit MoJo (Mobile Journalism).

Gjithashtu, NJAB në raportin e auditimit, konstaton se RTK nuk disponon me informacione nëse të gjithë personat të cilët tanimë nuk janë pjesë e RTK-së i kanë kthyer pajisjet/asetet që u janë dhënë në shfrytëzim. Në bazë të Rregullores Nr.0735/18, konkretisht nenit 2, RTK është e obliguar që të merr masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jofinanciare me qëllim të menaxhimit efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jofinanciare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Gjithashtu ky keqmenaxhim u konfirmua edhe në mbledhjen e Bordit me Menaxhmentin të datës 16.01.2022, ku Drejtori i Përgjithshëm ka konfirmuar se është e vërtetë që telefonat mobil u janë ndarë një pjesë të menaxhmentit dhe ish-Bordit të RTK-së, ndërsa përfaqësuesi i Departamentit të Financave ka konfirmuar që edhe përkundër kërkesës nga zyrtari kompetent për zyrtarët që tashmë nuk janë pjesë e RTK-së për t'i kthyer asetet e RTK-së, ato ende nuk janë kthyer të gjitha.

**Evidentohet shkelje ligjore dhe keqmenaxhim me kontratat dhe faturat.** Kjo konstatohet në Raportin e Auditimit të Regjistrimit të Hyrave 2021, ku sipas këtij raporti, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka rekomanduar që “delegimi i përgjegjësisë të natyrës së kontabilitetit tek zyrtarët e Departamentit të Marketingut (DM), mos disponimi i kontratave apo faturave, të lëshuara nga DM për klientët, nga Departamenti i Financave (DF), paraqesin çështje për shqetësim. RTK obligohet ta zbatojë në praktikë Rregulloren e Menaxhimit financiar (RrMF). E gjithë kjo praktikë ka rezultuar me mosrespektim të nenit 22, para. 1; nenit 33, para. 2 dhe 3; nenit 40, para. 2, nën-para. 2.1 dhe 2.2 të Rregullores së Menaxhimit financiar të RTK-së”.

Përgjegjësia e të gjitha këtyre shkeljeve më lartë bie mbi Drejtorin e Përgjithshëm, disa gjetje nga këto të konstatuara edhe nga Njësia e Auditorit të Brendshëm, për mos-ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe ndalimin e veprimeve të menaxhmentit të lartë dhe stafit të RTK-së për të keqpërdorur, keqmenaxhuar dhe për të shkelur ligjin, statutin, rregulloret dhe standardet profesionale të RTK-së. Në këto raste Drejtori i Përgjithshëm ka vazhduar të tolerojë shkelje të tilla e të mos ndërmarrë masa edhe përkundër faktit që shumica prej tyre janë identifikuar gjatë gjithë kohës, e që në këtë rast mosveprimi i tij në përputhje me kompetencat që ka, është shkelje e Ligjit të RTK-së, neni 33, pika 1.7, dhe Statuti i RTK-së, neni 20, pika 14, të cilat e obligojnë Drejtorin e Përgjithshëm që të ndërmerr masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme.

Arsyetimi i këtij vendimi bazohet nga gjetjet e identifikuar nga Bordi i RTK-së që nga konstituimi dhe mbledhja e parë e mbajtur me datë 16 dhjetor 2021. Gjetjet janë identifikuar gjatë katër (4) mbledhjeve të bordit të mbajtura me datat 16, 23 dhe 30 dhjetor 2021 si dhe nga mbledhja e mbajtur me datë 16 janar 2022, gjatë të cilave është diskutuar mbi gjendjen e RTK-së në bazë të informatave, diskutimeve dhe vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga Menaxhmenti i RTK-së dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm te Bordi i RTK-së.

Në të njëjtën kohë, Bordi i RTK-së konsideron se lista e gjetjeve, përkatësisht shkeljeve është më e gjatë dhe më e ngarkuar, mirëpo duke pasur parasysh që disa çështje të identifikuara janë subjekt i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, Inspektorati i Punës apo institucioneve tjera relevante, vendoset që ato gjetje të mos përfshihen në këtë vendim për shkak të subjektivitetit deri në vlerësim nga autoritetet kompetente.

**Prandaj**, duke marrë për bazë shkeljet e listuara në arsyetimin e këtij vendimi, Bordi i RTK-së, me datë 19 janar 2022, me nëntë (9) vota PËR dhe asnjë votë KUNDËR, ka aprovuar shkarkimin e z. Ngadhnjim Kastrati nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

**Kryetar i Bordit të RTK-së**

**Z. Besnik Boletini**



Vendimi i dërgohet:

- Z. Ngadhnjim Kastrati;
- Menaxhmentit të lartë të RTK-së;
- Sekretarisë së Bordit të RTK-së;
- Arkivit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.